

K O N T R A T E

Nr. 875 Date: 26.09.2016

Kjo kontrate lidhet sot me dt. 26.09.2016 , ndermjet Bashkise Dropull , *Gjirokaster*, qe ne vazhdimesi do te quhet *Autoriteti Kontraktor* dhe do te perfaqesohet nga *Z ,Ahilea DEÇKA Kryetar*, nga njera ane ,si dhe shoqerise "*ALBA KONSTRUKSION*" *SH.P.K. Tirane*, identifikuar perkatesisht me nipt *J61812013R* qe me poshte do te quhet *Kontraktuesi* dhe do te perfaqesohet nga shoqëria "*ALBA KONSTRUKSION*" *sh.p.k.* me Administrator *Z. Xhavit Ismaili*.

Kjo Kontrate perpilohet mbi baze te V.K.M. Nr. 914 Date 29.12.2014 "Per Rregullat e Prokurimit Publik , dhe mbi baze te marreveshjes ndermjet paleve kontraktuese duke specifikuar si me poshte:

Neni 1

Objekti i kesaj kontrate eshte "*Oender multifunkionale sherbimesh*" (*Sistemi i nje godine egzistuese*), "*per Bashkine Dropull, Gjirokaster*, sipas specifikimeve teknike te percaktuara ne dokumentet e Tenderit. Kjo kontrate do te jete "*Kontratë me Çmim / Njesi të bazuar në çmimet e njesise të shprehura në Preventivin ne Njesi, Sasi, Cmim ne Aneks -I te kesaj kontrate*, me cmime te pandryshueshme dhe eshte e detyrueshme per zbatimin nga te dyja palet ne kushtet qe percaktohen shprehimisht ne te dhe sipas ligjit , ndersa per ceshtje te tjera qe mund te lindin gjate zbatimit te saj dhe qe nuk parashikohen ne kete kontrate , do te zbatohen dispozitat perkatese te kodit civil si dhe dispozitat e tjera ligjore e nenligjore "*Per Prokurimet Publike*"

Neni 2

Vlera e kesaj kontrate , deri ne perfundim te punimeve te objektit, kolaudimit te tij dhe marrjes ne dorezim eshte *71.097.439 (Shtatedhjete e nje milion e nenedhjete e shtate mije e katerqind e tridhjete e nende) lek pa TVSH.*

Vlera me TVSH 85.316.927 (Tetedhjete e pese milion e treqind e gjashtembedhjete mije e nendeqind e njezete e shtate)leke me TVSH.

Fondi i vene ne dispozicion per vitin 2016 eshte 45.000.000 (Dyzete e pese milion)leke duke perfshire dhe TVSH-ne.

Paradhenie nuk do te aplikohet

Neni 3

Cmimi I kotrates eshte fiks dhe nuk ndryshohet.

Autoriteti Kontraktor nuk pranon asnje rritje cmimi te pretenduar nga Kontraktuesi.

Neni 4

Sipermarresi detyrohet qe perpara nenshkrimimit te kesaj kontrate te siguroje ate me nje shume ne masen *10% te vleres se kontrates ose 8.531.692 leke* , si garanci per perfundimin e punimeve , ne format e parashikuara me ligj.

Neni 5



Pagesa e Kontraktuesit do te behet nga Autoriteti kontraktor me paraqitjen e *situacionit pjesor ose përfundimtar, te firmosur nga Supervizori, Zbatuesi dhe Investitori, shoqeruar me faturen Tatimore te shitjes*, per ndertimin e objektit, me urdher xhirimi ne *llogarine rrjedhese te tij Nr. 2274, Iban: AL74 2121 1016 0000 0000 0000 2274 prane Credins Bank Sh.a*

Neni 6

Afati i perfundimit te punimeve te objektit ne baze te grafikut te punimeve llogaritur nga data e fillimit (data e dorezimit te sheshit te ndertimit) eshte **240 (dyqind e dyzete)** dite kalendarike. Ky afat nuk mund te ndryshohet ne asnje rast me perjashtim te rastit qe percaktohet ne nenin 10 te kesaj kontrate.

Neni 7

Garancia e punimeve eshte ne shumen **4.265.846 leke (5% te vleres se kontrates) dhe do te mbahet gjate likuidimit te situacioneve pjesore ose përfundimtar.** Periudha e garancise se defekteve do te jete **1 (nje) vit** nga data e firmosjes se **Akt-kolaudit dhe Akt-dorezimit.**

Neni 8

Nga data e fillimit te punimeve deri ne fund te periudhes se **“Garancise se objektit”** qe jepen ne te dhenat e kontrates, kontraktuesi do te perballoje rreziqet per shkak te demtimeve personale , vdekjes dhe humbjes ose demtime te pasurise (perfshire pa kufizime punimet , materialet dhe pajisjet)

Neni 9

Per ndjekjen e kesaj kontrate , ngarkohet **Mbikqyresi I punimeve (supervizori) Z.** _____ , i cili konform legjislacionit ne fuqi, pergjigjet per ndertimin e objektit, sipas kushteve teknike ne fuqi, per cilesine e zbatimit te punimeve, dhe te materialeve te ndertimit, per likujdimin e situacioneve dhe per plotesimin e dokumentacionit te dosjes se objektit qe nga momenti I fillimit te punimeve dhe deri ne ate te dorezimit te objektit.

Neni 10

Cdo ndryshim ne sasi, i urdheruar nga Autoriteti kontraktor , i cili sjell rritjen e vleres se kontrates, si dhe cdo suate e paparashikuar qe sjell zgjatjen e afatit te perfundimit te punimeve, do te jete detyrimisht objekt i nje procesverbali (urdheri) me shkrim te firmosur nga Autoriteti kontraktor. Keto urdhera do te hartohen ne baze te nje propozimi teknik nga cilado pale ne kontrate dhe I drejtohen drejtuesit te punimeve per kontaktim me palen tjeter. Mosmarreshjet mund te zgjidhen me rruge gjyqesore.

Ne rast se pengesat zgjidhen jashte gjyqesisht , menyra e zgjidhjes do te jete detyrimisht objekt I nje aneks -kontrate ku specifikohet zgjidhja e dhene, ne lidhje me problematiken e hasur ne zbatim te kontrates.

Neni 11

Perdorimi I fondit rezerve do te behet vetem me miratimin e Autoritetit kontraktor, mbas kerkeses me shkrim dhe te argumentuar nga drejtuesi I punimeve.

Neni 12

Pas lidhjes se kontrates Kontraktuesi detyrohet te kete dorezuar tek supervizori grafikun e punimeve te objektit . Supervizori do te firmose situacionet duke kontrolluar librezen e masave ne menyre periodike , me qellim qe marrja ne dorezim e objektit te mos kete probleme me volumet ose cilesine. Ne kete grafik duhet te percaktohet rradha e punimeve , afati I kryerjes se cdo procesi pune dhe vlerat qe ai do te realizoje cdo muaj. Paraqitja e ketij grafiku perben kusht themelor te kontrates.

Neni 13

Kontraktuesi do te permbushë, te gjitha detyrimet per sigurimet qe rrjedhin nga aktet ligjore dhe nenligjore ne fuqi dhe qe lidhen me rreziqet qe kontraktuesi duhet te perballoje, nga data e fillimit e deri ne fund te perfundimit te periudhes se garancise.

- a) demtimin e punimeve
- b) humbjen dhe/ose demtimin e materialeve dhe pajisjeve
- c) plagosjen ose vdekjen e personelit ne pune.

Neni 14

Punimet ne objekt nga ana e Kontraktuesit do te kryhen ne perputhje te plote me projektin, specifikimet teknike dhe preventivin me te cilat Kontraktuesi eshte njohur dhe mbi bazen e te cilave ka bere vleresimin dhe ka paraqitur oferten si dhe KTZ dhe grafikut te miratuar me fillimin e punimeve.

Neni 15

Ne rast te kryerjes se punimeve ne kundershtim me sa percaktohet me siper , Kontraktuesi do te pergjigjet vete per shpenzimet e kryera mbi vleren fikse te percaktuar ne kete kontrate dhe per vonesat ne perfundimin e objektit , sic parashikohet ne nenin 30 te kesaj kontrate.

Neni16

- Dokumentacioni teknik qe mbahet ne dosjen e objektit nga Kontraktuesi do te jete:
- Projekt zbatimi I objektit me rrjetin inxhinierik perkates se bashku me preventivat
 - Libreza e masave
 - Proces verbalet e punimeve te maskuara sipas formuleve te KTZ
 - Situacionet mujore dhe ai perfundimtar per punimet e kryera
 - Ditari I objektit sipas fomularit te percaktuar ne KTZ dhe I firmosur nga drejtori I punimeve (supervizori) I cili duhet te mbahet ne objekt gjate gjithe periudhes se punimeve.
 - Gjithe korrespondenca zyrtare me shkrim qe eshte bere midis paleve nga fillimi deri ne fund te punimeve.

Neni 17

Zbatimi I punimeve nga ana e sipermarresit ,do te behet ne perputhje te plote me KTZ ne fuqi sipas llojit te punimeve. Kontraktuesi mban pergjegjesi per qendrueshmerine e objektit dhe per punimet e maskuara qe ka kryer. Materialet qe do te perdoren ne objekt duhet te jene te reja, ne perputhje me standartet ne fuqi dhe te shoqeruara me certifikatat e cilesise qe leshohen nga nje laborator I licensuar ose nga nje laborator I kontrollit te cilesise ne rreth.

Neni 18

Cdo here qe drejtuesi I punimeve njoftohet apo verifikon nje defect apo te mete cilesore ne drejtim te cilesise se punimeve, te materialeve te ndertimit apo punimeve te maskuara , drejtuesi I punimeve mban process verbalin perkates duke lene detyra dhe Kontraktuesi do te korrigoje defektin apo te meten me shpenzimet e veta brenda afatit te parashikuar nga njoftimi I drejtuesit te punimeve. Autoriteti kontraktor kontrollon zbatimin e detyrave te lena dhe kur ato jane zbatuar, ben shenimin perkates ne process verbalin e mbajtur.

Neni 19

Ne rast se detyrat e lena ne process verbal nuk jane zbatuar nga ana e Kontraktuesit ne afatin e caktuar Autoritetit kontraktor I lind e drejta t'a prishe kontraten ne menyre te njeanshme. Drejtori I punimeve do te vleresoje koston e korrigjimit te defektit apo te te metes dhe Kontraktuesi do te paguaje kete shume , ose Autoriteti kontraktor do ta mbaje kete shume duke zbritur nga pagesa e llogarise perfundimtare. Ne rast se kjo nuk mjafton pjesen tjeter e ndal nga garancia e derdhur nga Kontraktuesi per garantimin e perfundimit te punimeve.

Neni 20

Ne rast se Kontraktuesi gjate vazhdimit te punimeve kryen punime me cilesi te dobet, apo perdor materiale qe nuk plotesojne kerkesat e standarteve shteterore, te cilat vene ne rrezik qendrushmerine e objektit , Autoriteti kontraktues jo vetem ka te drejte te prishe kontraten ne menyre te njeanshme, te mos lejoje likujdimin e punimeve te kryera, por kerkon penalizim, deri ne perjashtim nga Procedurat e Prokurimeve Publike.

Neni 21

Preventivi perfshin te gjitha zerat e punimeve qe duhet te kryhen per perfundimin e objektit dhe te perdoret per te llogaritur vleren e kontrates.

Neni 22

Kontraktuesi detyrohet te filloje punimet Brenda _____ *diteve* nga data e nenshkrimit te kesaj kontrate. Ne rast vonese te shkaktuar nga moslirimi ne kohe I sheshit te ndertimit , Autoriteti kontraktues , ben shtyrjen e afatit te dorezimit te objektit dhe, ne kete rast. Kontraktuesi nuk ka te drejte te pretendoje asnje demshperblim per kete vonese.

Neni 23

Ne rast se Kontraktuesi per cdo arsye qofte (me perjashtim te voneses se shkaktuar nga moslirimi I sheshit te ndertimit), nuk I fillon punimet ne afatin e mesiperm, ose pas fillimit te punimeve I nderpret ato dhe nuk i rifillon brenda nje periudhe kohe prej 15 ditesh, Autoritetit kontraktues I lind e drejta t'a prishe kete kontrate ne menyre te njeanshme.

Neni 24

Drejtori I punimeve (supervizori) do te kerkoje nga Kontraktuesi zbatimin e grafikut te punimeve per cdo ze pune ne kohe dhe ne vlere . Drejtori I punimeve do te kontrolloje zbatimin e ketij grafiku dhe ne rast se do te konstatoje shkelje te tij , do te njoftoje menjehere Autoritetin kontraktues. Autoriteti kontraktues per mosrealizimin e punimeve sipas grafikut

te punimeve te miratuar nga vete ai, do t'i mbaje kontraktuesit vleren sipas nenit 34 te Kushteve te Pergjithshme te Dokumentave Standarte.

Neni 25

Ne rast se Kontraktuesi ne mbarim te gjysmes se afatit te perfundimit te objektit nuk ka realizuar punimet ne vlere sipas grafikut, Autoriteti Kontraktues ka te drejte te prishe kontraten ne menyre te njeanshme duke I konfiskuar Kontraktuesit sigurimin e kontrates.

Neni 26

Autoriteti Kontraktues do te paguaje Kontraktuesin, ne baze te situacioneve mujore qe kontrollohen dhe miratohen nga ana e tij nepermjet drejtuesit te punimeve (supervizorit), duke ~~zbritur~~ **5% te vleres** se cdo situacioni , si garanci per cilesine e punimeve . Me paraqitjen e situacioneve nga Kontraktuesi , pagesat do te kryhen Brenda 30 diteve nga dita e paraqitjes se situacioneve. Kontraktuesi nuk ka te drejte te pretendoje ndaj Autoritetit Kontraktor asnje demshperblim per mosfinancimin ne kohe te punimeve ne rastin e celjes me vonese te fondeve.

Neni 27

Zerat e punimeve , per te cilat nuk eshte vene cmimi per nje njesi ne oferten e paraqitur do te konsiderohen si te mbuluara nga vlerat e tjera te perfshira ne kontrate.

Neni 28

Ne rast se situacioni I paraqitur nuk I paguhet kontraktuesit Brenda 30 diteve me perjashtim te rastit te parashikuar ne paragrafin e fundit te nenit 25 , Autoriteti Kontraktor detyrohet te paguaje sipas nenit 34 te Kushteve te Pergjithshme te Dokumentave standarte, te shumes se parapaguar. Ajo do te llogaritet per c'do dite vonese mbas 30 diteve nga paraqitja e situacioneve.

Neni 29

Ne qofte se situacioni I nje muaji se bashku me interesat perkatese nuk I paguhen Kontraktuesit edhe mbas 60 diteve te tjera, ketij te fundit I lind e drejta qe ai ta prishi kete kontrate ne menyre te njeanshme.

Neni 30

Ne perfundim te objektit ose dhe ne rastin e prishjes se kesaj kontrate per cdo arsye qofte , Kontraktuesi do te paraqese situacionin perfundimtar per shumen qe pretendon se duhet te shlyhet, gjithmone ne perputhje me sa percaktohet ne kontrate.

Neni 31

Ne rast te shkeljes se afatit perfundimtar te objektit , sic eshte percaktuar ne kontrate , Kontraktuesi detyrohet te paguaje nje kamate vonese sipas nenit 34 te Kushteve te Pergjithshme te Dokumentave Standarte ne dite te vleres se kesaj kontrate

Neni 32

Autoriteti Kontraktor e ndal kete kamate vonese nga situacioni perfundimtar dhe ne rast se kjo nuk mjafton, pjesen tjeter e ndal nga garancia qe Kontraktuesi ka derdhur ne llogari te Autoritetit Kontraktues per garantimin e perfundimit te punimeve.

Neni 33

Ne rast te prishjes se kesaj kontrate pala qe e prish ate do te njoftoje menjehere me shkrim palen tjeter dhe do te kerkoje zbatimin e te gjitha detyrimeve qe percaktohen ne kontrate.

Neni 34

Ne cdo rast te prishjes se kesaj kontrate Kontraktuesi detyrohet te ndaloje menjehere punimet, te largoje mjetet dhe materialet nga kantieri , te siguroje ruajtjen e objektit deri ne marrjen ne dorezim nga Autoriteti Kontraktor dhe te paraqese siguracionin per punimet e kryera . Autoriteti Kontraktor Brenda 30 diteve duhet te marre ne dorezim punimet e kryera dhe te beje likujdimin e pageses .

Neni 35

Kur konstatohen gabime te zbatimit te projektit apo shkelje te cilesise se punimeve nga Kontraktuesi , por qe nuk mund te riparohen dhe nuk ndikojne negativisht ne anen konsrutive apo funksionale te objektit, Autoriteti Kontraktor ka te drejte qe nga garancia e Kontraktuesit te mbaje nje vlere qe e gjykon te arsyeshme.

Neni 36

Kontraktuesi me perfundimin e punimeve ,njofton me shkrim Autoritetin Kontraktor se objekti eshte perfunduar plotesisht pa asnje te mete dhe eshte I gatshem per t`u kolauduar dhe marre ne dorezim.

Neni 37

Autoriteti Kontraktor me marrjen e ketij njoftimi nga supervizori , Brenda 30 diteve duhet te beje kolaudimin dhe marrjen ne dorrezim te objektit ne perputhje te plote me dispozitat ligjore dhe nenligjore ne fuqi.

Neni 38

Ne qofte se Autoriteti Kontraktor gjate periudhes se kolaudimit dhe marrjes ne dorezim te objektit, konstaton te meta apo mangesi te cdo natyre qofshin ato, mban process-verbal te vecante duke caktuar nje afat per riparimin e te metave dhe plotesimin e mangesive nga Kontraktuesi me shpenzimet e ketij te fundit.

Neni 39

Ne rast se mbas 15 ditesh Kontraktuesi nuk ka filluar punen per riparimin e mangesive Autoriteti Kontraktor ka te drejte te caktojte nje sipermarres per riparimin e te metave dhe plotesimin e mangesive dhe te gjitha shpenzimet e kryera, I ndalen

Kontraktuesit te pare nga pagesa e llogarise perfundimtare dhe ne rast se kjo nuk eshte e mjaftueshme I ndal ato nga Garancia.

Neni 40

Kontraktuesi eshte I detyruar te shlyeje rregullisht te gjitha taksat , tatimet, siguracionet e nevojshme qe parashikohen ne dispozitat ligjore e nenligjore.

Neni 41

Per taksat e percaktuara me legjislacion qe ka hyre ne fuqi 28 dite para hapjes se ofertave , te cilave , Kontraktuesi duhet t'i kete te parashikuara ne Vleren e Kontrates, Autoriteti Kontraktues nuk do te njohe asnje shtese ne pagese.

Neni 42

Mbas kolaudimit dhe dorezimit te objektit Kontraktuesi mban pergjegjesi dhe eshte I detyruar me shpenzimet e veta , te beje riparimet e punimeve si me poshte, sipas ketyre afateve:

- Per punimet e strukturave te mur guri deri ne 12 muaj nga data e dorëzimit.
- Per punimet dhe materialet e rrethimit , deri 12 muaj nga data e dorëzimit.

Neni 43

Cdo mosmarreveshje qe mund te linde gjate zbatimit te te kesaj kontrate do te zgjidhet me mirekuptim nepermjet bisedimeve te drejteperdrejta midis paleve. Ne rast se mosmarreveshja nuk do te jete e mundur te zgjidhet ne kete menyre , Brenda 30 diteve pala e interesuar mund te kaloje ceshtjen ne ***Gjykatën e Rrethit Gjirokaster*** per t'a zgjidhur ate.

Neni 44

Kjo kontrate eshte e detyrueshme per zbatim nga te dyja palet. Pasi u lexua dhe u pranua prej tyre pa verejtje, nenshkruhet nga perfaqesuesit perkates.

Kontrata perbehet nga 7 (shtate) flete dhe hartohet ne kater kopje nga te cilat nje e mban Kontraktuesi ***"ALBA KONSTRUKSION" SH.P.K Tirane*** dhe tre kopje ***Autoriteti Kontraktor, Bashkia Dropull , Gjirokaster***

Gjirokaster me: 26.09.2016

PER AUTORITETIN KONTRAKTOR

Bashkia Dropull, Gjirokaster

KRYETARI

Arilea DEÇKA



PER KONTRAKTUESIN

"ALBA KONSTRUKSION" SH.P.K

Perfaqesuar nga ADMINISTRATORI

Xhavit Ismaili

